



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**V E N D I M**

**Nr. 609, datë 16.10.2024**

**PËR**

**PËR PËRFUNDIMIN E PROCEDIMIT DISIPLINOR NR. 1/2024 TË FILLUAR NDAJ ISH MAGJISTRATES {...}, PA NJË VENDIM PËRFUNDIMTAR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, më datë 16.10.2024, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore, aktet e procedimit disiplinor nr. 1/2024 që i përket :

**KËRKUES:**

**Inspektori i Lartë i Drejtësisë**, përfaqësuar me autorizim nga z. {...}.

**SUBJEKT I PROCEDIMIT:** Magjistratja {...},

**OBJEKTI I KËRKESËS:**

1. Fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates znj. {...}, me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë
2. Propozimin për caktimin e masës disiplinore :  
- “Shkarkim nga detyra”

**BAZA LIGJORE:**

Neni 138; neni 102, pika 1, shkronja “d”; neni 111 i Ligjit nr. 96/2016, “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe të Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Në seancë dëgjimore, pas shqyrtimit të çështjes sipas parashikimeve të nenit 142 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, mbi propozimin e relatores znj. Gentiana Muçaj, për përfundimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj ish magjistrates znj. {...} pa një vendim përfundimtar, Këshilli

## V Ë R E N:

### I. TË DHËNA MBI FILLIMIN E PROCEDIMIT DISIPLINOR

1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, me shkresën nr. 2292/30 prot., datë 12.01.2024 ka depozituar për shqyrtim pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, me datë 16.01.2024, kërkesën me objekt *Fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates znj. {...} me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.*

2. Në kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka paraqitur propozimin për caktimin e masës disiplinore “Shkarkim nga detyra” ndaj magjistrates znj. {...} të parashikuar nga nenet 105, pika 1, shkronja *dh* dhe 111 të Ligjit nr. 96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe të Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

3. Pas depozitimit të kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates {...}, me vendimin nr. 29, datë 24.01.2024, Këshilli ka vendosur të caktojë si relatore të çështjes, znj. Gentiana Muçaj, në cilësinë e anëtarit të Komisionit Disiplinor. Vendimi për caktimin e relatorit të çështjes i është njoftuar palëve të procedimit disiplinor përkatësisht Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe magjistratëve, brenda afatit 5 ditor të parashikuar në nenin 141 të Ligjit për Statusin.

4. Me vendimin nr. 39, datë 31.01.2024, mbi propozimin e relatorit të çështjes, Këshilli ka vendosur kalimin e çështjes në seancë dëgjimore, për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates {...}, duke njoftuar rregullisht palët në zbatim të parashikimeve të nenit 138 të Ligjit për Statusin.

4.1 Magjistratja znj. {...} ushtronte funksionin e gjyqtares pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, dhe ishte me status të pezulluar, referuar vendimit nr. 437 datë 10.09.2021 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me të cilin ka vendosur : “1. *Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. {...}, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.....*”. Nga verifikimi i faqes elektronike të Komisionit të Posaçëm të Apelimit rezultonte se ankimi dhe vendimi i KPK-së janë në proces shqyrtimi deri në vendimmarrje të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit regjistruar çështja (JR) nr. 69/2021, datë 11.11.2021).

5. Në referim të këtyre fakteve dhe të kësaj situatë juridike, Këshilli i Lartë Gjyqësor në referim të neneve 126, 145 të Ligjit Për Statusin, si dhe në lidhje me nenin 66 të K.Pr.Administrative, ka konsideruar se jemi në kushtet e pezullimit të procedimit disiplinor të filluar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë deri në përfundim të çështjes së rivlerësimit, duke vlerësuar se mbajtja ose jo e statusit të magjistratit nga ajo, përbën parakusht për shqyrtimin në themel të procedimit disiplinor ndaj saj.

5.1 Në këto kushte, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin nr. 97 datë 29.02.2024 ka vendosur :

1. *Pezullimin e procedimit disiplinor nr. 1/2024 të filluar ndaj magjstrates znj. {...}, me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, deri në marrjen formë të prerë të vendimit nr. 437 datë 10.09.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.*

6. Rezulton se më datë 03.07.2024<sup>1</sup>, Kolegji i Posaçëm i Apelit pas shqyrtimit të ankimit ndaj Vendimit nr. 437, datë 10.09.2021 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, ka vendosur:

*“– Lënien në fuqi të vendimit nr. 437, datë 10.09.2021 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit {...}.*

*– Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm”.*

7. Sa sipër, shkak i pezullimit të procedimit disiplinor, konsideruar nga Këshilli, në vendimin e tij nr. 97 datë 29.02.2024 për “Pezullimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj magjstrates znj. {...}, me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, deri në marrjen formë të prerë të vendimit nr. 437 datë 10.09.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”, ka rënë dhe nuk ekziston më.

7.1 Në këto kushte, Komisioni Disiplinor në mbledhjen e datës 08.07.2024 vendosi t'i parashtrijë Mbledhjes Plenare projekt vendimin për Shfuqizimin e vendimit nr. 97 datë 29.02.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor për “Pezullimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj magjstrates znj. {...}, me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, deri në marrjen formë të prerë të vendimit nr. 437 datë 10.09.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”.

8. Pas shqyrtimit të propozimit të Komisionit Disiplinor, sa sipër, Këshilli me vendimin e tij nr. 357 datë 11.07.2024 ka vendosur :

1. *Shfuqizimin e vendimit nr. 97, datë 29.02.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për pezullimin e procedimit disiplinor nr. 1/2024 të filluar ndaj magjstrates znj. {...}, me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”, deri në marrjen formë të prerë të vendimit nr. 437, datë 10.09.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.*

8.1 Në vijim, me qëllim vijimin e shqyrtimit të këtij procedimi disiplinor, Këshilli me vendimin nr. 551 datë 01.10.2024 ka vendosur :

1. *Caktimin e datës 16.10.2024, ora 12.00, si datë e zhvillimit të seancës dëgjimore, për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjstrates znj. {...}, me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.*

---

<sup>1</sup> <https://kpa.al/njoftim-vendimi-248/>

## II. VLERËSIMI PËR VIJIMIN E SHQYRTIMIT TË PROCEDIMIT DISIPLINOR

9. Nga Këshilli në seancën dëgjimore të datës 16.10.2024, u kërkua qëndrimi i palëve në proces lidhur me vijimin e shqyrtimit të procedimit disiplinor.

9.1 Përfaqësuesi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, referuar situatës ligjore aktuale, i kërkoi Këshillit të Lartë Gjyqësor, të vendosë përfundimin e procedimit disiplinor ndaj ish magjistrates {...}, për shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 102, pika 1, shkronja “d”, e Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pa një vendim përfundimtar.

9.2 Ndërsa ish magjistratja znj. {...} konfirmoi faktin e vendimmarrjes së KPA-së dhe nuk kishte gjë për të shtuar lidhur me kërkesën e parashtruar nga Inspektori.

10. Lidhur me vijimin e shqyrtimit të çështjes, rezulton se me marrjen formë të prerë të vendimit nr. 437 datë 10.09.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, znj. {...} ka humbur statusin e magjistratit, duke mos ushtruar më këtë funksion.

11. Procesi i rivlerësimit kalimtar dhe procedimi disiplinor sipas Ligjit për Statusin, janë dy procese të pavarura nga njëri tjetri, që zhvillohen nga organe të ndryshme, të pavarura dhe sipas procedurave jo të njëjta, rrethana këto që, pavarësisht faktit që ato zhvillohen ndaj të njëjtit magjistrat, bëjnë të pamundur bashkimin e tyre në një procedim të vetëm. Ndërkohë këto procese kanë ndikim ndaj njëri tjetrit, duke përcaktuar vijueshmërinë e tyre. Kështu, procesi i rivlerësimit, që është një proces i detyrueshëm për të gjithë gjyqtarët në detyrë (në momentin e miratimit të ndryshimeve kushtetuese të vitit 2016), përcakton vijimin e gëzimit nga ata të statusit të magjistratit sipas Ligjit për Statusin. Nga ana tjetër, moskalimi me sukses i procesit të rivlerësimit passjell mbarimin e menjëhershëm të statusit të magjistratit, rrethanë kjo që përbën shkak për mbylljen e procedimit disiplinor sipas Ligjit për Statusin, referuar nenit 139, pika 1, shkronja “c”<sup>2</sup> në lidhje me nenin 134, pika 1, shkronja “ç”<sup>3</sup>, nenin 64, pika 1, shkronja “ç”<sup>4</sup> dhe nenin 164, të tij.

12. Neni 164 i Ligjit për Statusin, në dispozitat e tij kalimtare, përcakton se: “1. Gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë gëzojnë statusin e magjistratit të parashikuar në këtë ligj vetëm nëse: ...b) kalojnë me sukses procesin e rivlerësimit, në përputhje me ligjin “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.”

---

<sup>2</sup> “1. Këshilli vendos mbylljen e procedimit disiplinor pa zhvilluar seancë dëgjimore nëse: ...; c) ka arsye të tjera për të mbyllur procedimin, në përputhje me parashikimet e nenit 134, pika 1, shkronjat “ç” dhe “d”; ...”.

<sup>3</sup> “1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë mbyll hetimin, nëse provohet se pretendimet janë të pabazuara ose provat e mbledhura dhe rezultatet e hetimit të çojnë drejt përfundimit se: ...; ç) magjistratit i mbaron statusi, bazuar në kriteret e parashikuara, në shkronjat “b” deri në “ç”, të pikës 1, të nenit 64, të këtij ligji...”.

<sup>4</sup> “1. Statusi i magjistratit mbaron në rastet kur: ...; ç) shkarkohet nga funksioni për përgjegjësi disiplinore, sipas parashikimeve të këtij ligji; ...”.

13. Neni 179/b, pika 7, e Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, ka parashikuar se :“7. *Moskalimi me sukses i procesit të rivlerësimit përbën shkak për mbarimin e menjëhershëm të ushtrimit të detyrës, krahas shkaqeve të parashikuara në Kushtetutë. ...*”.

14. Neni 139, pika 1, shkronja c, i Ligjit për Statusin, përcakton se: “1. *Këshilli vendos mbylljen e procedimit disiplinor pa zhvilluar seancë dëgjimore nëse: ...c) ka arsye të tjera për të mbyllur procedimin, në përputhje me parashikimet e nenit 134, pika 1, shkronjat “ç” dhe “d”;..*”.

15. Neni 134, pika 1, shkronja ç, i Ligjit për Statusin, përcakton se: “1. *Inspektori i Lartë i Drejtësisë mbyll hetimin, nëse provohet se pretendimet janë të pabazuara ose provat e mbledhura dhe rezultatet e hetimit të çojnë drejt përfundimit se: ...ç) magjistratit i mbaron statusi, bazuar në kriteret e parashikuara, në shkronjat “b” deri në “ç”, të pikës 1, të nenit 64, të këtij ligji ose nuk ushtron funksionin e tij në mënyrë të përhershme, sipas parashikimeve të nenit 67 të këtij ligji;..*”.

16. Neni 64, pika 1, shkronja ç, i Ligjit për Statusin, përcakton se: “1. *Statusi i magjistratit mbaron në rastet kur: ...ç) shkarkohet nga funksioni për përgjegjësi disiplinore, sipas parashikimeve të këtij ligji;..*”.

17. Në kushtet kur znj. {...} nuk e gëzon më statusin e magjistratit, nuk është objekt i veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor, referuar neneve 147 dhe 147/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, sipas të cilave Këshilli është autoriteti shtetëror që siguron pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë, ku vendos për masat disiplinore ndaj gjyqtarëve të të gjitha niveleve.

18. Në vijim, referuar nenit 95 të K.Pr.Administrative - Pamundësia në objekt apo qëllim - i cili shprehet se : “*Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur*”, shqyrtimi i procedimit disiplinor të filluar ndaj ish magjistrates znj. {...}, duhet ndërprerë/mbyllur pa një vendim përfundimtar për shkak se objekti apo qëllimi për të cilin kishte nisur është bërë i pamundur.

### **III. KONKLUZIONI**

19. Bazuar sa sipër, në kushtet kur znj. {...} nuk e gëzon më statusin e magjistratit, nuk mund të jetë më objekt i veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor, për rrjedhojë shqyrtimi i procedimit disiplinor të filluar ndaj saj, duhet ndërprerë pa një vendim përfundimtar për shkak se objekti apo qëllimi për të cilin kishte nisur është bërë i pamundur.

## **PËR KËTO ARSYE**

Mbështetur në nenet 147, 147/a, 179/b, pika 7, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 64, 134, 139 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 97, 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, Këshilli i Lartë Gjyqësor

### **V E N D O S I :**

1. Përfundimin e procedimit disiplinor nr. 1/2024 të filluar ndaj ish magjistrates znj. {...}, pa një vendim përfundimtar.
2. Një kopje e vendimit t’i njoftohet znj. {...} dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të apelit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

### **PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**